

## MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË QENDRËN E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

Raporti Përfundimtar i Auditimit i ushtruar në Qendrën e Studimeve Albanologjike me objekt “Auditimin financiar” për periudhën 01.01.2014 deri më 31.12.2015 si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH nr.26, datë 31.03.2016. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, me shkresën nr.1027/8, datë 31.03.2016, i është dërguar Qendrës së Studimeve Albanologjike, “Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet”.

### A. OPINIONI I AUDITUESIT

#### Opinion i kualifikuar.

Në gjykimin e KLSH-së, si edhe mbështetur në ISSAI 1705<sup>1</sup>, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara te “*Bazat për opinion të kualifikuar*”, pasqyrat financiare vjetore të Qendrës së Studimeve Albanologjike, paraqesin drejtë, të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të QSA-së më datë 31.12.2014 dhe rezultatet e operacioneve dhe flukseve të arkës, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Është në përgjegjësinë tonë, si auditues të pavarur, të shprehemi se, parregullsitë e konstatuara sa më sipër ofrojnë një bazë të mjaftueshme për dhënien e opinionit të kualifikuar.

#### **Bazat për opinion të kualifikuar mbi besueshmërinë e pasqyrave financiare.**

Nga auditimi u konstatua se, grupi i auditimit, nuk jep dot siguri të arsyeshme mbi vlerën kontabël të njohur si **Aktive të trashëgimisë kulturore për një vlerë totale prej 217,622,005 lekë**, për shkak të pasaktësive të konstatuara në evidentimin e këtyre aktiveve si dhe llogaritjes gabim të amortizimit për këto aktive. Konstatuam përfshirje të këtyre aktiveve, me pa të drejtë brenda zërit të Inventarit Ekonomik të Aseteve të Trashëgimisë Kulturore e për rrjedhojë përlllogaritja në nivel grupi e amortizimit të këtij zëri për një vlerë rreth **43,524,401 lekë** (me një normë 20%), ka shtrembëruar vlerën e aktivitetit deri dhe vetë qëllimin që ka raportimi financiar për të siguruar *informacion rreth pozicionit financiar, performancës dhe ndryshimeve të pozicionit financiar të një njësie, i cili është i dobishëm për një gamë të gjerë përdoruesish me impakt në vendim-marrje.*

Pasaktësi konstatuam në llogaritjen dhe pasqyrimin e amortizimit të **Aktiveve të Patrupëzuara në vlerën 2,495,441 lekë**. Nuk është respektuar parimi i kontabilitetit rritës në përgatitjen e pasqyrave financiar, me efekte në rezultati e periudhës në masën **954,812 lekë**. **Nga sa më sipër, konstatohet se pasqyrat financiare të QSA-së mbartin një gabim material prej 46,974,654 lekë.**

### B. MASA ORGANIZATIVE

Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se, për aktivet e patrupëzuara nuk është përlllogaritur amortizim, në kundërshtim me VKM 783, date 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, i ndryshuar dhe me Udhëzimi nr. 5, datë 30.01.2006

<sup>1</sup> **ISSAI 1705:** Objektivi i audituesit është të shprehë qartë një opinion të modifikuar mbi pasqyrat financiare, i nevojshëm nëse (...) audituesi e ka të pamundur të sigurojë evidencat e duhura për të konkluduar se, pasqyrat financiare nuk përmbajnë gabime materiale dhe që transaksionet e kryera, përputhen në të gjitha aspektet materiale me ligjet dhe rregullat në fuqi.

“Për tatimin mbi të ardhurat”, ku kërkohet përlllogaritja e këtij zëri në masën 15%, duke mos u reflektuar vlera e amortizimit prej 2,495,441 lekë për këtë zë.

Ndërsa për aktivet e trupëzuara, në zërin makineri e pajisje operacionale, instrumenta e vegla që kërkojnë amortizim me 5.8% konstatohet se është përdorur norma 20%. Në zërin inventar ekonomik, janë përfshirë aktive si pajisje informatike e kompjuterike që kërkojnë një normë amortizimi 25% dhe jo 20% sikundër është përlllogaritur dhe regjistruar.

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Institucioni të marrë masa të menjëhershme, të bëjë rilloaritje të amortizimit dhe të reflektoje vlerën prej 2,495,411 lekë në mbyllje të bilancit kontabël për vitin 2015, duke kryer edhe gjithë sistemimet e nevojshme kontabël që lidhen më veprimin. Në vijimësi të ndiqet e njëjta politikë kontabël në trajtimin e këtij zëri.

#### **Menjëherë dhe në vazhdim**

**2.** Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se, **Fondet e Trashëgimisë Kulturore**, nën administrimin e QSA-së, nuk identifikohen si zë më vete në pasqyrat financiare, por si pjesë e Inventarit Ekonomik, së bashku me aktive të tjera si mobilje zyresh, kompjutera, etj. Informacioni i raportuar nuk është vetëm gabim teknik klasifikimi brenda zërave të bilancit, por në rastin e QSA flitet për mos evidentim të saktë të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe krijimin e hapësirave për mos-administrim të kujdesshëm të këtyre objekteve të rëndësisë së veçantë (kështu raportuar në një zë objektet e zyrove, laptop, pc, tavolina etj të ngjashme së bashku me objekte si statuja, kostume popullore, objekte bronzi që i takojnë periudhave të ndryshme etj), në kundërshtim me Udhëzimin nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësite që varen prej tyre si dhe të njësiteve të menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”.

Kjo “pasaktësi” në klasifikim është shoqëruar edhe me amortizim me një normë prej 20%, për Asetet e Trashëgimisë Kulturore (si statuja ilire, varesë, veshje popullore, etj) **ndërkohë që sipas standardeve të kontabilitetit këto aktive nuk amortizohen pasi vlera e tyre, ndryshe nga gjithë asetet e tjera kontabël, jo vetëm nuk pakësohet (për efekt amortizimi), por shtohet me kalimin e kohës. Kjo përlllogaritje e amortizimit, ka sjellë një rritje të amortizimit në vlerën 43,524,401 lekë, vetëm për fondet etnografike.**

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Institucioni të marrë masa për të evidentuar me saktësi dhe në një grup të veçantë të zërave të aktivitet **Fondet e Trashëgimisë Kulturore**, organizuar me nën-ndarje sipas karakteristikave të tyre. Të hartohet një manual kontabël për trajtimin e këtyre aktiveve që nga njohja, evidentimi deri tek praktikat e rivlerësimit. Kur është e nevojshme të realizohet ky proces dhe efektet vetëm në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare kjo me qëllim raportimin e drejtë financiar, në shërbim të vendim marrjes efektive, veçanërisht asaj të lidhur me menaxhimin e fondeve të trashëgimisë kulturore.

#### **Menjëherë dhe në vazhdim**

**3.** Nga auditimi u konstatua se, brenda të njëjtit grup aktivesh (këtu i referohemi fondeve të trashëgimisë kulturore), është bërë rivlerësimi pjesor (vetëm për fondet etnografike). Pjesa tjetër e fondeve vijon të ketë vlerë sipas përcaktimeve përpara vitit 1990. Bazuar në standardet e kontabilitetit nuk lejohet të bëhet rivlerësim vetëm i një grupi aktivesh brenda të njëjtës klase sepse jo vetëm shtrembërohet informacioni mbi pasqyrat financiare por dhe çënohet cilësia e raportimit financiar.

Nga auditimi u konstatua se janë kontabilizuar me vlerë 0 (zero), objektet arkeologjike në Korçë; dhe pjesërisht objektet arkeologjike në Muzeun Arkeologjik Tiranë.

Më datë 18.02.2013, është kryer inventarizimi dhe rivlerësimi i Fondeve Etnografike të Materialeve të Përziera, të cilat vijonin të ishin me vlera të viteve para 1990-ës, por konstatuam se për rivlerësimin është përdorur një *formulë e thjeshtë*, që konsiston në shumëzimin me 100 herë për artikuj me vlerë mbi 50 lekë; dhe shumëzimi me 30 herë për artikuj me vlerë nën 50 lekë bazuar në nivelin e rritjes së pagave (procedura e ndjekur nuk mbështetet mbi bazë rregullative). Një aplikim kaq i thjeshtëzuar i indeksimit, mbi vlera të trashëgimisë kulturore është i vështirë për tu vlerësuar (pothuajse i pamundur të aplikohet). Gjithashtu përdorimi i metodës mbështetur mbi indeksimin e pagave, në gjykimin tonë, nuk mund të reflektojë edhe vlerën kulturore të objektit. Tipari i pazëvendësueshmërisë, dhe vlera në rritje me kalimin e kohës edhe pse në kushtet fizike të përkeqësuar vështirëson përcaktimin e jetëgjatësisë së objektit, sidomos për objekte arkeologjike ku jetëgjatësia është e pambarimtë. Këto faktorë duhen mbajtur parasysh gjatë vlerësimit të objekteve, mbështetur edhe në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik (IPSAS 17), me qëllim që vlerësimi i kryer nga institucioni të rezultojë i besueshëm dhe objektiv.

QSA, si institucioni më i rëndësishëm kërkimor-shkencor dhe akademik i botës shqiptare (citurar në Statut), ka për të detyrë të studiojë, vlerësojë dhe promovojë trashëgiminë materiale e shpirtërore të kulturës së lashtë dhe të re shqiptare, si dëshmi të identitetit të saj. QSA-së i ka munguar tërësisht iniciativa për të nisur një proces korrekt rivlerësimi të trashëgimisë kulturore – objektet në përgjegjësi administrimi e QSA-së, i cili të jetë objektiv dhe real e i mbështetur në ekspertizën e kësaj Qendre por edhe në praktikën më të mira të vendeve të tjera, e që t’i shërbejë edhe raportimit të shëndoshë financiar.

Nga auditimi u konstatua se, Instituti i Arkeologjisë dhe Instituti i Kulturës Popullore (aktualisht IAKSA), nuk kanë përmbushur detyrën e tyre bazë, që është përcaktimi i vlerave të trashëgimisë nën administrimin e drejtpërdrejtë të tyre, si “institucione shtetërore të specializuara”, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003 ”Për trashëgiminë kulturore”, neni 3 dhe neni 7.

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

QSA dhe veçanërisht Instituti i Arkeologjisë dhe Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Arteve (IAKSA) të marrin masa të menjëhershme për të nisur dhe përfunduar vlerësimin e objekteve që kanë nën administrim mbështetur në ekspertizën që zotërojnë si “institucione shtetërore të specializuara”, si edhe me profesionalizëm dhe sipas kriterëve shkencorë.

QSA në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, të përgatisë dhe ndjekë miratimin e një Udhëzimi për Vlerësimin, Inventarizimin dhe evidencën kontabël të Aseteve të Trashëgimisë Kulturore, mbështetur në praktikën më të mira, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik SNKP 17 (IPSAS 17), ku në varësi të objekteve, të jepen informacione shpjeguese sa i takon, modelit të zgjedhur të vlerësimit (me kosto, vlerë rivlerësimi, vlerë tregu), metodën e përcaktimit të jetëgjatësisë së tyre; personat e mundshëm për të realizuar vlerësimin e këtyre aktiveve dhe procedurat për realizimin e këtij misioni dhe aspekte të tjera që lidhen me mirë-administrimin e këtyre vlerave.

#### **Menjëherë dhe në vazhdim**

**4.** Nga auditimi gjithashtu u konstatua se, vetëm në Fondet e Kulturës materiale e tekstile dhe aksesore të veshjeve, mungojnë 83 objekte (si qostekë, varëse, kryqe, jelekë, breza, kuleta, riza, opinga, medaljone, etj), ndërkohë që vlera e tregut nuk është përcaktuar dhe as vlerësuar paraprakisht. Humbja pretendohet të jetë konstatuar që në Tetor 1999, për të cilën është mbajtur edhe procesverbal (pa datë dhe pa numër protokolli). Lidhur me këtë humbje, grupit

të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë evidencë, që të tregojë masat e marra nga Institucioni për nxjerrjen e përgjegjësive personale të humbjes së objekteve, si dhe marrjen e masave për zhdëmtimin e dëmit të pallogaritshëm të shkaktuar në Fondet e Trashëgimisë Kulturore.

Referuar Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, është Nëpunësi Autorizues, që jep urdhër për zhdëmtimin, për mungesat e konstatuara në ngarkim të personave me përgjegjësi materiale. Nëpunësi Zbatues ndjek procesin dhe kryen regjistrimet kontabël përfundimtare. Nga auditimi u konstatua se nuk ka ndonjë urdhër për zhdëmtim, e si pasojë ndonjë masë të marrë për rastin në fjalë.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Nëpunësi Autorizues në mënyrë të menjëhershme, të propozojë në linjë hierarkike deri tek Titullari masa lidhur me trajtimin e mëtejshëm të aktivitetit të dëmtuar/humbur, si dhe masa administrative ndaj shkaktarët deri në ndjekjen penale të tyre.

Për të shmangur raste të tilla flagrante, Titullari i Institucionit të hartojë procedurat specifike në lidhje me masat që do të ndërmerren për kompensimin, zëvendësimin dhe / ose riparimin e aktiveve, ku të parashikohen mënyra e vlerësimit të dëmit (në bazë të vlerës së drejtë, e cila asnjëherë nuk mund të jetë më të vogël se vlera e tyre kontabël) në rastet kur konstatohen prishje dhe dëmtime në aktivitet afatgjatë materiale, e që u ngarkohen fajtorëve.

**Menjëherë**

5. Nga auditimi u konstatua se për Aktivitetet e Trashëgimisë Kulturore nuk është kryer inventarizim periodik sipas kërkesave të Udhëzimit 30, datë 26.12.2011 dhe ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore”. Mungesa e kryerjes së inventarizimit periodik, gjithashtu sjell rrezikun e mos-gjetjes së përgjegjësive individuale dhe institucionale, në rast të humbjes/vjedhjes së objekteve pasi, referuar një vendimi “Për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. 1408, të vitit 2007, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në fund të vitit 2007, në Inventarin e Fondeve të Përziera, mbi humbjen e 129 objekteve, për të cilat Gjykata shpalli të pafajshëm përgjegjësin e fondeve, në mungesë të kryerjes së inventarizimeve periodike, për të evidentuar periudhën e saktë gjatë së cilës këto fonde kishin humbur dhe si pasojë të identifikohet se nën cilën përgjegjësi kishin qenë këto objekte. Ky rast përforcon nivelin e lartë të riskut, përballë të cilit ekspozohet institucioni në rastet kur mungon një proces korrekt dhe periodik i inventarizimit, sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011.

Nga ana tjetër konstatuam raste kur personat që kanë në ngarkim/përdorim aktivin, kanë qenë gjithashtu pjesë e grupit të inventarizimit, praktikë në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, dhe që komprometohet edhe saktësinë e procesit.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Institucioni të marrë masa për kryerjen e inventarizimeve periodike vjetore me qëllim vërtetimin e saktësisë, cilësisë e gjendjes fizike të tyre në një kohë të caktuar, si edhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efikasitet. Në asnjë rast të mos caktohet pjesë e grupit të inventarizimit, por të jetë i pranishëm në proces përgjegjësi material të fondeve.

**Menjëherë dhe në vazhdim**

6. Nga auditimi janë konstatuar raste kur personat që kanë në ngarkim/përdorim aktivin, kanë qenë gjithashtu pjesë e grupit të inventarizimit, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Në asnjë rast të mos caktohet pjesë e grupit të inventarizimit, por të jetë i pranishëm në proces përgjegjësi material të fondeve.

**Menjëherë dhe në vazhdim**

7. Nga auditimi u konstatua mungesa e regjistrit të aktiveve, në varësi të llojit si edhe grupit përkatës brenda llojit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011. Është detyrë e çdo njësie publike që të krijojë dhe përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim. Regjistri duhet të mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Nëpunësi Autorizues i njësisë brenda strukturës së institucionit, të caktojë nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit. Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën administrimin e njësisë.

**Menjëherë dhe në vazhdim**

8. Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se, gjatë inventarizimit të Fondit me Objekte Arkeologjike, në Apoloni, kryer më datë 10.04.2014, janë konstatuar 375 objekte pa numër inventari në Regjistrin Themeltar Të Apolonisë, të cilat vështirësojnë procesin e identifikimit të këtyre aseteve, e ku specifikohet se shkak i fshirjes së numrave, që vështirësojnë gjetjen e numrit të regjistrit themeltar të objektit arkeologjik, janë ndërhyrjet mbi objekt (larje, restaurime, etj). Konstatuam se 109 objekte të dëmtuara si edhe 961 objekte arkeologjike, pjesërisht pa numër inventari në Regjistrin Themeltar të Apolonisë, janë vazhdimisht të kërcënuar nga agjentë atmosferike, për shkak të kushteve të këqija të ruajtjes me arsyen e “oksidimit” të objekteve; ose “baltë e dobët”. **Nga këto konstatime, del në pah, nevoja emergjente e Institucionit për të ofruar siguri të lartë për ruajtjen në kushte normale për objektet e trashëgimisë kulture, me qëllim mos-prishjen e tyre dhe realizimin e objektivit për të cilin këto objekte ekzistojnë.** Nga auditimi u konstatua se QSA nuk ka një plan mirëmbajtjeje për aktivet me qëllim planifikimin e fondeve të nevojshme për të orientuar shpenzimet drejt punës parandaluese, në kundërshtim me paragrafin 23, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Prej kësaj del nevoja urgjente që këto objekte të rrala kanë, sa i takon kushteve të mirëmbajtjes dhe restaurimit, në përputhje me kërkesat VKM nr. 426, datë 13.07.2007 “Për miratimin e kartës shqiptare të restaurimit”.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

QSA në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës të hartojë listën e objekteve të rrezikuara, që kanë nevojë për ndërhyrje urgjente restauruese.

Gjithashtu, institucioni të marrë masa të menjëhershme për të minimizuar riskun e lidhur me këto aktive sa i takon mbrojtjes fizike të tyre (kundër vjedhjes, dëmtimeve natyrore, etj, nëpërmjet ekzistencës së një sistemi për regjistrimin e dëmeve dhe për garantimin se veprimet e duhura po merren me shpejtësi). Institucioni duhet të hartojë planin e mirëmbajtjes së aktiveve me qëllim planifikimin e fondeve të nevojshme me qëllim orientimin e shpenzimeve drejt punës parandaluese sesa drejt riparimit. Gjithashtu QSA duhet të kryejë inventarizime periodike vjetore.

**Menjëherë dhe në vazhdim**

9. Nga auditimi është konstatuar se në Qendrën e Studimeve Albanologjike nuk ka një kuptim të mirëfilltë të të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ‘Për menaxhimin financiar dhe kontrollin’, i ndryshuar. Konkretisht nga auditimi është konstatuar se në këtë institucion në kundërshtim me nenin 4, pikat 22 - 23, dhe nenin 8 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ‘Për menaxhimin financiar dhe kontrollin’ nuk është përcaktuar siç duhet nëpunësi autorizues. Sipas ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin Titullari i institucionit është kreu i organit qendror të njësisë publike, ndërsa nëpunësi autorizues është nëpunësi i nivelit më të lartë të menaxhimit të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, i caktuar nga titullari dhe përgjegjës për zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha strukturat dhe programet buxhetore, duke përfshirë planifikimin, zbatimin, monitorimin e kontrolleve të risqeve të lidhura me zbatimin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin financiar të njësisë së qeverisjes së përgjithshme. Nga auditimi është konstatuar se në këtë institucion vepron si nëpunës autorizues z. Arben Skënderi, por grupit të auditimit nuk i është vendosur në dispozicion shkresa e konfirmimit të tij nga ana e Ministrisë së Financave. (Trajtuar më hollësisht në faqen nr. 33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Institucioni të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim rritjen ndërgjegjësimit brenda strukturave të brendshme të rëndësisë së menaxhimit financiar dhe kontrollit duke organizuar për këtë qëllim edhe trajnime të cilat të përfshijnë të gjitha instancat e përfshira në zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

**Menjëherë dhe në vazhdim**

10. Nga auditimi u konstatua se, nga inspektimi fizik i objekteve, mungonin “specifikimet” të domosdoshme për identifikimin e tyre nëpër rafte si edhe mungesa e katalogimit informatik (dokumentimin sipas kritereve shkencore), në përputhje kjo edhe me “Udhëzuesit Metodik për Drejtuesit e Institucioneve dhe Personat që merren me kartelizimin e objekteve të trashëgimisë kulturore” i Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore, në Ministrinë e Kulturës. Ky udhëzues përcakton informacionin që duhen plotësuar në kartelat elektronike të objekteve që janë: fusha, kategoria tipi, titulli i objektit, materialet, teknika, kultura (vendase, e huaj..e specifikuar), periudhat (mesjeta, antikitet, shekulli e viti nëse ka), e të tjera informacione të domosdoshme, regjistrimi korrekt i të cilëve është një punë e vështirë dhe me përgjegjësi shkencore, që kërkon vëmendje dhe seriozitet. Nga auditimi u konstatua se QSA ka nisur pjesërisht e me ritme të ngadalta regjistrimin e objekteve të trashëgimisë kulturore në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore, pranë së cilës është database i gjithë trashëgimisë kulturore të Shqipërisë, me qëllim pajisjen me pasaportë të objekteve, sipas kërkesave të nenit 3 dhe 7 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Institucioni të marrë masa të menjëhershme për nisjen dhe përfundimin e procesit të inventarizimit dhe katalogimit elektronik për të gjitha objektet e trashëgimisë kulturore që ka në ngarkim, me qëllim identifikimin, studimin, botimin dhe promovimin, ruajtjen e tyre, si edhe parandalimin e eksportimit të paligjshëm të tyre, të cilat shkaktojnë një varfërim të trashëgimisë kulturore kombëtare. Pajisja me pasaportë e secilit prej objekteve të trashëgimisë kulturore të konsiderojë krijimin e kartelës elektronike dhe “hard copy” të objektit, shoqëruar me foto, filmime, skica, vendndodhja, përmasat, pasha, materiali, autori, vendi i ruajtjes, përshkrimi, historiku dhe kodi kompjuterik i objektit.

**Deri në fund të vitit 2016**

**11.** Nga auditimi i inventarizimit të Objekteve Arkeologjike të Muzeut Arkeologjik Tiranë u konstatua se, sipas inventarit të bërë në 2007-ën, në vitrinë rezultojnë 2 objekte më pak (114 në vend të 116), pasi këto objekte respektivisht me nr. Rendor 10, e nr. Inventari 16089 dhe nr. Rendor 49 e nr. Inventari 16099, janë nxjerrë jashtë përdorimit për shkak dëmtimi, sipas procesverbalit të datë 01.03.2006, të pa protokolluar. **Nga auditimi u konstatua se, nuk ka asnjë bazë ligjore që parashikon nxjerrjen jashtë përdorimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, pasi ato mund të restaurohen.**

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Për dy objektet arkeologjike, të konstatuara si “të nxjerra jashtë përdorimit” me pa të drejtë, me Nr. Rendor 10, e Nr. Inventari 16089 dhe Nr. Rendor 49 e Nr. Inventari 16099, QSA dhe Instituti i Arkeologjisë të marrin masa të menjëhershme për identifikimin e saktë të tyre, vlerësimin dhe regjistrimin e tyre në Aktivitet e veta të QSA-së, ku të specifikohet qarte grupi i aktiveve ku do të kalojnë këto objekte.

**Menjëherë dhe në vazhdim**

**12.** Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se, Njësia e Financës në të gjitha rastet e regjistrimit kontabël të shpenzimeve, është ndjekur parimi i pagesave dhe arkëtimeve, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për Miratimin e Planit Kontabël Publik”, i ndryshuar. duke shtrembëruar “Rezultatin nga Funkcionimi” për një vlerë totale prej 954,812 lekë, si edhe duke përfshirë pa të drejtë një vlerë prej 17,063,624 lekë në llog 831 “Caktim të ardh. Funks. Për investime”, për të korigjuar rezultatin e për të arritur te niveli i dëshiruar i likuiditetit. **Këto veprime kanë bërë që “Rezultati nga Funkcionimi” në vlerën 27,661,548 lekë, në fakt të përfaqësojë gjendjen e likuiditetit më 31.12.2014<sup>2</sup> dhe jo Rezultatin Ekonomik, të cilët janë dy koncepte tërësisht të ndryshëm nga njëri – tjetri, por njëloj të rëndësishëm për procesin e vendimmarrjes.**

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Institucioni të marrë masa të bëjë gjithë sistemimet e domosdoshme në mbyllje të pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2015, duke u mbështetur mbi parimin e të drejtave të konstatuara.

**Brenda datës 30.03.2016**

**13.** Nga auditimi i zonave të llogarisë, u konstatua se, njësia e financës nuk i mban të dhënat në formë elektronike. Nga auditimi i listëpagesave u konstatua se, për vitin 2014, 11 punonjës (personel akademik), kanë tejkaluar normën vjetore të mësimdhënies (30%), për të cilën pagesa është bërë pa miratim nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 20, datë 09.05.2008 “Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”, i ndryshuar, një vlerë totale prej **1,875,360 lekë.**

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Institucioni të marrë masa në kuadër të një menaxhimi më eficient, efektiv dhe ekonomik të orëve të punës, por edhe të fondeve buxhetore, që të mos tejkalojë nivelin prej 30% të orëve të mësimdhënies. Në rastet kur kjo normë tejkalohet, Drejtuesit e çdo Instituti, të paraqesin kërkesën në Këshillin e Institutit dhe në Senatit Akademik, ku të reflektohen qartë dhe saktë arsyet e tejkallimit, e në të gjitha rastet, nëse këto kërkesa aprovohen nga Senati, të kërkohet miratimi nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, përpara ekzekutimit të pagesës nga ana e Sektorit të Financës.

---

<sup>2</sup> Edhe kjo me rezerva për arsyet e përmendura në gjetje

## **Menjëherë dhe në vazhdim**

**14.** Nga auditimi u konstatua se në mungesë të planifikimit të të ardhurave dytësore të QSA-së, ky institucion ka funksionuar pa një rregullore mbi mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat, në kundërshtim nenin 73 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 96 të statutit të QSA-së.

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Institucioni të marra masa të hartojë Rregulloren e Brendshme, ku të përcaktohen qartë mënyra e përdorimit të të ardhurave, sa i takon administrimit dhe kontabilizimit, me qëllim rritjen e transparencës dhe efektivitetit të procesit të planifikimit dhe zbatimit të këtyre planeve, për të ardhurat e krijuara nga vetë institucioni.

## **Menjëherë dhe në vazhdim**

**15.** Nga auditimi u konstatua se, Njësia e Financës, i plotëson çdo muaj nga jashtë e manualisht borderotë e pagave, sipas formatit të kërkuar me ligj, por më pas e fshin dokumentin për të punuar mbi të njëjtin, edhe për muajin pasardhës. Kjo gjë jo vetëm që rrit mundësinë e gabimit njerëzor, shmang ruajtjen e të dhënave elektronike në mënyrë kronologjike, por gjithashtu vështirëson punën e auditimit për verifikimin e zërave.

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

QSA duhet të marra masa të menjëhershme, të regjistrojë çdo veprim financiar në një program të dedikuar kontabiliteti, me qëllim rritjen e cilësisë së të dhënave dhe mundësinë e ruajtjes së gjurmëve të çdo veprimi ekonomik financiar të regjistruar në kontabilitet

## **Menjëherë dhe në vazhdim**

**16.** Nga auditimi është konstatuar se me katër urdhra të janë ngritur komisionet e inventarizimit dhe me anë të këtyre urdhrave është ngritur edhe komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve i përbashkët për të katër institutet përbërëse të QSA. Nga auditimi i procedurës së inventarizimit është konstatuar se nuk janë zbatuar kërkesat e udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve të njësive të sektorit publik”, duke mos u shoqëruar me procesverbale dorëzimi i pasqyrave të inventarizimit; si edhe duke munguar gjurmët e dorëzimit të tyre te personi përgjegjës - nëpunësi autorizues i institucionit, brenda afatit kohor.

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Qendra e Studimeve Albanologjike për sa i takon procedurave të inventarizimit të marrë masa për të dokumentuar hapat e kryerjes së inventarizimit me qëllim arritjen e përfundimit të kësaj procedure sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Menjëherë dhe në vazhdim**

**17.** Nga auditimi është konstatuar se është pasqyruar gabim vlera e llogarisë 327, pasi reflekton çeljen në fillimi të vitit 2014 në vlerën 3,910,543 lekë dhe jo gjendjen më 31.12.2014 në vlerën 2,642,699 lekë. Si rrjedhojë totali i pakësimeve 2,156,511 lekë, për vitin 2014 i përbërë nga nxjerrje jashtë përdorimit (inventar i imët) në vlerën 1,267,844 lekë, si dhe transferimet në vlerën 888,667 lekë nuk është reflektuar fare në bilanc. Gjithashtu konstatuam se procedura e nxjerrjes jashtë përdorimit është kryer nga zyra e financës së institucionit, e cila nuk e ka dokumentuar atë (në asnjë rast), dhe nuk e ka reflektuar në bilanc shumën prej **1,267,844 lekë**, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 26.12.2011. Në momentin e mbylljes së këtij auditimi, grupit të auditimit i është dorëzuar një

informacion përmbledhës i praktikës së ndjekur së bashku me pasqyrat e përpiluara nga financa për të dokumentuar aktivet tashmë jashtë përdorimit.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Institucioni të marrë masa për të kryer rregullimet përkatëse në bilancin e institucionit me qëllim pasqyrimin e saktë dhe të vërtetë të gjendjes së llogarive. Gjithashtu të marrë masa që në të ardhmen të dokumentojë me procesverbale përkatëse procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve.

**Menjëherë**

**18.** Nga auditimi është konstatuar se, ka qenë problematikë e hershme pronësia e objektit ku ndodhet Laboratori i Konservimit dhe Arkeometrisë i cili ndodhet pranë Pedonales së Tiranës, në shtëpinë e Toptanëve. Për arsye të moszgjidhjes së këtij problemi, që është jashtë përgjegjësive të QSA-së, prej vitit 2009, ky laborator nuk përdoret më për restaurim nga ana QSA dhe nuk ka qenë i mundur as tërheqja e makinerive dhe objekteve të tjera që ndodhen në të, me qëllim rindërtimin e tij diku tjetër. Për këtë arsye, ka qenë e pamundur kryerja e inventarizimit, ndërsa regjistrimi kontabël i këtij zëri i referohet verifikimit të fundit fizik që ka mundur të bëjë QSA, më datë 15.10.2010. Duke iu referuar procesverbalit më të fundit të viti 2010, nga auditimi u konstatua se, në ambientet e laboratorit mungojnë të 4 objekte.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Institucioni, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit të angazhohen në tërheqjen e materialeve të ruajtura pranë ish-Laboratorit të Konservimit dhe Arkeometrisë me qëllim vlerësimin e përdorshmërisë së tyre, si dhe të vlerësohet mundësia e rindërtimit të tij në një vend tjetër të përshtatshëm.

**Menjëherë**

**19.** Nga auditimi është konstatuar se personi përgjegjës për magazinën e institucionit nuk ka ruajtur dokumentacionin e magazinës për vitin 2014. Grupi i auditimit e merr të mirëqenë që ky dokumentacion nuk ekziston, pasi pas kërkesave të shumta verbale ai ende nuk na është vënë në dispozicion. Në mungesë të evidencave për verifikimin e vlerës së magazinës, grupi i auditimit nuk jep dot siguri të arsyeshme rreth saktësisë së vlerës kontabël prej 30,456,396 lekë.

Gjithashtu, nga auditimi konstatohen fletë hyrje magazine pa numër rendor; gjendja e mbajtjes së dokumentacionit të magazinës është e çrregullt dhe nuk gjenden të gjitha fletë hyrjet dhe fletë daljet nga magazina; është vendosur vetëm gjendja e inventarit më 31.12.2014 për sasi, çmim dhe vlerë, pa u pasqyruar më tej hyrjet dhe daljet të aktiveve gjatë vitit 2015, në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011. Nga auditimi u konstatua se, nuk ekziston dokumentacion i magazinës për vitin 2014 dhe nuk kuptohet se si është përfshirë në inventar dhe si është kontabilizuar vlera e magazinës në fund të vitit 2014.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Institucioni të marrë masat e duhura dhe të menjëhershme me qëllim gjetjen e dokumentacionit të magazinës për vitin 2014, si dhe të verifikojë nëse vlera e magazinës në fund të vitit 2014 pasqyruar në bilanc është e saktë.

Gjithashtu, institucioni të marrë masa të menjëhershme me qëllim rregullimin e përmirësimin e situatës sa i takon procesit korrekt të magazinimit, duke evidentuar përgjegjësitë përkatëse në mënyrë që të evitohen në të ardhmen gabime të kësaj natyre.

**Menjëherë dhe në vazhdim**

20. Nga auditimi është konstatuar se *për periudhën janar – tetor 2015* marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara nuk është kryer përmes **komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve** të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin. Hyrjet në magazinë janë kryer nëpërmjet hartimit të fletë hyrjeve, por në asnjë rast ato nuk janë shoqëruar me procesverbalin përkatës, kompetencë e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve, në të cilin duhet të jenë të detajuara të dhënat e verifikuara dhe mos-përputhjet me faturën dhe kushtet e kontratës, nëse ka. Për këtë arsye hyrja në magazinë e aktiveve të furnizuara është kryer pa respektuar procedurat e specifikuar dhe pa dokumentet mbështetëse të kërkuara nga udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, *Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara*.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Institucioni të marrë masa përmes urdhrave të brendshëm për të krijuar komisionin e marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuar sipas sasisë, llojit dhe cilësisë, me qëllim kryerjen e verifikimeve të përputhshmërisë së mallit të dorëzuar nga operatorët ekonomik me termat e kontratave të nënshkruara nga QSA.

**Menjëherë dhe në vazhdim**

21. Nga auditimi me zgjedhje i fletë hyrjeve në magazinë është konstatuar se në një rast është bërë hyrje në magazinë të laptopit me vlerë **85,857 lekë** si aktiv i dëmtuar, e që ka nevojë për riparim, por nuk është mbajtur procesverbal ku të sqarohet problematika e ndodhur me aktivin dhe të justifikohet dërgimi i tij për riparim. Në asnjë rast nuk i duhet bërë hyrje në magazinë, pasi presupozohet se pas servisit ai aktiv do të jetë përsëri në përdorim të personit që e ka në ngarkim. Për sa më sipër është konstatuar se institucioni nuk ka rregulla të mirë përcaktuara për aktivet e dëmtuara ose të prishura për konstatimin e dëmtimit të aktivitetit, procedurën që duhet ndjekur për të justifikuar riparimin e tij kur është i mundur, si dhe konstatimin e përgjegjësive për dëmtimin e shkaktuar nëse ka. Nga auditimi është konstatuar se në raste të largimit nga puna të punonjësve (për arsye të ndryshme) nuk është kryer dorëzimi i aktiveve që ata kanë në ngarkim në kundërshtim me pikën 13 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011. Gjithashtu është konstatuar se nuk ekzistojnë rregulla të vendosura nga Nëpunësi Autorizues të cilat të përcaktojnë procedurën që duhet të ndiqet në këto raste dhe se si kjo procedurë duhet dokumentuar nga personat përgjegjës për ruajtjen e aktiveve.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Institucioni të marrë masat e nevojshme për të hartuar rregulla të qarta me qëllim pasqyrimin e saktë të veprimeve të magazinës së QSA.

**Menjëherë dhe në vazhdim**

22. Nga auditimi është konstatuar se në kuadër të projektit ‘Historia e Shqiptarëve në shekullin e XX-të’, financuar nga Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, janë likuiduar shpenzime udhëtimi dhe dietë në vlerën totale **766,400 lekë, për shërbime që nga auditimi u konstatuan të pakryera** (për ████████ në Bullgari në vlerën 366,400 lekë, ████████ në Bullgari në vlerën 400,000 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 870, datë 10.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” dhe UMF nr. 22, datë 10.07.2013 ‘Mbi zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit’. Nga auditimi u konstatua se nga totali i paradhënies të marrë nga ████████ është përdorur vetëm vlera prej **33.600 lekë** për shërbimin në Shkup (Maqedoni) me qëllim kryerjen e kërkimeve arkivore, por për të cilin nuk është zbatuar procedura e kërkuar nga VKM dhe UMF të sipërcituar.

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Institucioni të marrë hapat e duhura me qëllim verifikimin e dokumentimit të ngjarjes (pra realizueshmërinë e shërbimit) dhe nëse shërbimi nuk dokumentohet si i kryer, të kërkohet arkëtimin *nga personat përfitues* të vlerës totale **732,800 lekë** (diferenca pa shumën 33.600 lekë). Në vijim, institucioni nuk duhet në asnjë rast të lejojë që paradhënia e dhënë me qëllim kryerjen e një shërbimi jashtë vendit të përdoret për një shërbim tjetër, për më tepër kur shërbimi i parë ende nuk është kryer.

**Menjëherë**

**23.** Nga auditimi është konstatuar se Qendra e Studimeve Albanologjike më datë 27.01.2015 ka nënshkruar Marrëveshjen e Financimit, pa numër protokoll, për organizmin e Aktivitetit 'Iliria e Jugut dhe Epiri në Antikitë', Konferencë e VI Ndërkombëtare, me Universitetin e Lion II, përmes së cilës QSA përfiton ndihmë financiare në vlerën 22,000 euro. Nga auditimi është konstatuar se në nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje nga ana e QSA është vepruar në kundërshtim me nenin 3 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 'Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare', si dhe pikën 2.1 të Udhëzimit nr. 8, datë 17.02.2003, 'Për evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj'. Nga auditimi i termave të marrëveshjes së financimit është konstatuar se në nenin 7 të saj përcaktohet se kjo marrëveshje i nënshtrohet ligjit francez. Nga auditimi është konstatuar se në mungesë të një miratimi sipas përcaktimit të udhëzimit nr. 8, datë 17.02.2003, vihet në dyshim kompetenca e QSA për të nënshkruar një marrëveshje e cila do të zbatohet në Shqipëri, me skemë të plotë thesari por që i nënshtrohet ligjit francez.

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Me qëllim garantimin e transparencës në kuadrin e projekteve kërkimore të QSA të cilat financohen nga sponsorizues së huaj, Institucioni të angazhohet dhe të kontaktojë instancat përkatëse me qëllim marrjen e orientimeve metodologjike dhe ligjore të sakta për të siguruar një zbatim të këtyre marrëveshjeve në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**Menjëherë dhe në vazhdim**

**24.** Nga auditimi është konstatuar se, për organizmin e eventit objekt i marrëveshjes së sipërcituar nga ana e QSA nuk janë zbatuar procedurat e prokurimit publik, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 'Për prokurimin publik', i ndryshuar si vijon:

- Është likuiduar operatori ekonomik E.A për organizmin e eventit 'Iliria e Jugut dhe Epiri në Antikitë' sipas kontratës së datës 30.03.2015, për vlerën 2,407,426 lekë, për të cilin nuk janë kryer nga ana e institucionit, procedurat e prokurimit publik.

- Është likuiduar vlera prej 55,000 lekë si shpenzime për konferencën 'Iliria e Jugut dhe Epiri në Antikitë, ndaj operatorit ekonomik [REDAKTUAR], për të cilën është lëshuar urdhri i prokurimit, por procedura nuk është realizuar dhe nuk është mbajtur procesverbali i rasteve të emergjencës më datë 18.05.2015, ku nuk janë reflektuar të dyja datat e zhvillimit të procedurës së prokurimit elektronik.

- Me urdhër shpenzimin nr. 92, datë 11.06.2015 është likuiduar shpenzimi në vlerën 128,000 lekë për operatorin ekonomik [REDAKTUAR], për të cilin është lëshuar urdhri i prokurimit nr. 01, datë 12.05.2015, si dhe është mbajtur nga komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël procesverbali i rasteve të emergjencës më datë 13.05.2015 për mos realizimin e procedurës. Në të nuk pasqyrohen të dy datat në të cilat ka dështuar procedura e prokurimit.

- Me urdhër shpenzimin nr. 91, datë 11.06.2015 është likuiduar vlera prej 86,760 lekë ndaj operatorit ekonomik [REDAKTUAR], për të cilin është lëshuar urdhri i prokurimit nr. 02, datë

14.05.2015 dhe më datë 15.05.2015 është mbajtur procesverbali i rasteve të emergjencës, ku nuk janë pasqyruar të dy datat e dështimit të procedurës së prokurimit elektronik.

- Me urdhër shpenzimin nr. 107, datë 07.05.2014 për blerje karburanti është likuiduar vlera prej 159,100 lekë për të cilën nga ana e institucionit nuk janë zhvilluar procedurat e prokurimit publik.

- Me urdhër shpenzimin nr. 70, datë 28.05.2015 janë likuiduar shpenzimet e konferencës (pritje/përcjellje) “Ditët e Albanologjisë” në vlerën 257,050 lekë kundrejt operatorit ekonomik [REDAKTUAR], e cila është autorizuar me urdhrin e titullarit nr. 434, datë 13.05.2015, por pa specifikuar se çfarë shërbimesh janë përfshirë konkretisht në këtë vlerë, si dhe pa zhvilluar procedura të prokurimit publik për organizimin e këtij eventi.

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Institucioni të marrë masa me qëllim unifikimin e praktikave të brendshme dhe të sigurojë zbatimin e procedurave të prokurimit publik për sa i takon të gjitha aktiviteteve që zhvillohen në kuadër të projekteve shkencore të QSA.

#### **Menjëherë dhe në vazhdim**

**25.** Nga auditimi është konstatuar se më urdhër shpenzimet nr. 226, datë 05.11.2014 dhe nr. 138, datë 10.08.2015 përkatësisht me vlerë **261.554 lekë** për pagesën e përkthimit në anglisht të librit ‘Arti Bashkëkohor Shqiptar’. Për kryerjen e këtij shërbimi institucioni ka nënshkruar marrëveshjen nr. 317, datë 18.06.2013 me [REDAKTUAR] bashkëlidhur së cilës mungojnë dokumente specifike të cilat të vërtetojnë që ajo është përkthyes e autorizuar nga Ministria e Drejtësisë, ose prove të njohjes së gjuhës angleze.

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Për realizimin e përkthimeve specifike të fushës së studimit të Qendrës së Studimeve Albanologjike, institucioni të kontraktojë në të ardhmen pedagogë dhe/ose punonjës shkencorë të barasvlershëm me ta, me një përvojë mbi 10 vjet në mësimdhënien e gjuhës në nivel universitar apo në fushën e përkthimit zyrtar që plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 9 të udhëzimit nr. 3165, datë 12.5.2004 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përkthyesve të jashtëm, tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët”, i ndryshuar, duke marrë në konsideratë të veçantë vlerësimin e të dhënave profesionale të kandidatëve.

#### **Menjëherë dhe në vazhdim**

**26.** Për sa i takon identifikimit të risqeve sipas kërkesave të nenit 10 të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe duke marrë në konsideratë natyrën e veçantë të punës me risqe të lartë të një institucioni kërkimor – shkencor siç është QSA, nga auditimi është konstatuar se institucioni nuk ka përcaktuar koordinatoren e riskut. Gjithashtu nuk ka të miratuar strategjinë e risqeve, e cila është kërkesë e nenit 21 të ligjit të sipërcituar. Nga auditimi është konstatuar se institucioni nuk ka të miratuar Grupin për Menaxhimin Strategjik, por çështjet që i përkasin kompetencës së këtij grupi adresohen sipas rastit nga organet drejtuese të QSA siç janë Senati Akademik për sa i takon aspekteve didaktike dhe Këshilli i Administrimit për çështje administrative. Çështje të tjera të menaxhimit strategjik të institucionit diskutohen edhe në nivel të Këshillave të Profesorëve të secilit institut për bërës të QSA. Mbledhjet e këtyre organeve janë të dokumentuara me procesverbalet, diskutimet dhe vendimet përkatëse, por mungon një koordinim i përgjithshëm institucional për problematikën e risqeve financiare dhe jo financiare me të cilat haset ky institucion.

Gjithashtu nga auditimi është konstatuar se institucioni nuk ka një procedurë të ngritur për evidentimin dhe dokumentimin e gabimeve, por problemet trajtohen rast pas rasti sipas specifikave përkatëse.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Institucioni të marrë masa me qëllim që çështjet të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin strategjik të institucionit, të diskutohet dhe dokumentohen nëpërmjet mbledhjeve periodike të Grupit të Menaxhimit Strategjik, duke përfshirë këtu edhe kontributet e organeve të tjerë përbërës të QSA.

Institucioni të angazhohet për të bërë rregullimet e nevojshme në strukturë me qëllim vendosjen e sektorit të financës së institucionit në vartësi direkte të nëpunësit autorizues.

**Menjëherë**

**27.** Nga auditimi është konstatuar se, në kundërshtim me ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe me nenin 51, pika 1/a të Statutit të Qendrës së Studimeve Albanologjike, institucioni nuk ka të miratuar një strategji zhvillimi ku të përcaktohen qëllimet dhe objektivat zhvillimore strategjike të tij në tërësi, si dhe në veçanti të secili prej instituteve që e përbëjnë atë. Nga auditimi është konstatuar se ekziston praktika e planifikimit të punës kërkimore në nivel institutesh, në nivel sektorësh dhe në nivel pune individuale të secilit kërkues sipas fushave përkatëse, por mungon një koordinim i përgjithshëm strategjik në një dokument të miratuar nga Senati Akademik sipas propozimeve të Këshillit Shkencor, praktikë kjo e cila do të rezultonte kështu në përputhje me dispozitat e sipërcituara të Statutit të QSA.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Për sa i takon delegimit të firmës së titullarit, të hartohen rregullat dhe procedurat e nevojshme në të cilat të përcaktohet në cilat raste dhe në çfarë mënyre do të lejohet delegimi i firmës sipas përcaktimeve të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

**Menjëherë dhe në vazhdim**

**28.** Nga auditimi është konstatuar se në kundërshtim me ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe me nenin 51, pika 1/a të Statutit të Qendrës së Studimeve Albanologjike, institucioni nuk ka të miratuar një strategji zhvillimi ku të përcaktohen qëllimet dhe objektivat zhvillimore strategjike të tij në tërësi, si dhe në veçanti të secili prej instituteve që e përbëjnë atë. Nga auditimi është konstatuar se ekziston praktika e planifikimit të punës kërkimore në nivel institutesh, në nivel sektorësh dhe në nivel pune individuale të secilit kërkues sipas fushave përkatëse, por mungon një koordinim i përgjithshëm strategjik në një dokument të miratuar nga Senati Akademik sipas propozimeve të Këshillit Shkencor, praktikë kjo e cila do të rezultonte kështu në përputhje me dispozitat e sipërcituara të Statutit të QSA.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Institucioni të ndërmarrë hapa me qëllim hartimin e një strategjie zhvillimi institucionale e cila të reflektojë, në përputhje dhe në zbatim edhe të Statutit të QSA-së objektivat strategjike afatshkurtër dhe afatgjatë të tij.

**Menjëherë**

**29.** Nga auditimi u konstatua se, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, Neni 12 .VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, Kreu I, pika 1,3/b dhe Udhëzimet e APP. Ligji nr.

10296, datë 08.07.2010, për “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Neni 15, 22, nuk ka asnjë urdhër të Autoritetit Kontraktor me të cilin ngarkohet Njësia e Prokurimit, ku të kërkohet përgatitja e kërkesave për përgatitjen e Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimeve.  
**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Titullari i Autoritetit Kontraktor apo personi i autorizuar prej tij të marrë masa për miratimin e urdhrin nga ku të kërkohet përgatitja e kërkesave për përgatitjen e Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimeve.

**Menjëherë**

**30.** Nga auditimi u konstatua se, në të gjitha dosjet e audituara, për prokurimet me vlerë të vogël mungon Urdhri i Titullarit për ngritjen e grupit të punës për të bërë testimin e tregut dhe përllogaritja e fondit limit është bërë mbi bazë të çmimeve të tregut nga punonjës të pa autorizuar nga Titullari. Gjithashtu nuk gjenden oferta të ngjashme apo tregues të tjerë që përcaktojnë fondin limit, në disa të tjera mungon relacioni përmbledhës apo procesverbalet e firmosur nga njësia e prokurimit mbi përllogaritjen e fondit limit para daljes së Urdhër Prokurimit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 33, datë 11.07.2013 “Gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, dhe Udhëzimin nr. 2, datë 28.03.2013 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Titullari i Autoritetit Kontraktor apo personi i autorizuar prej tij të marrë masa për miratimin e urdhrin nga ku të kërkohet ngritjen e grupit të punës për të bërë testimin e tregut.

**Menjëherë**

**31.** Nga auditimi u konstatua se, në të gjitha dosjet mungon raporti i vlerësimit final, që gjenerohet nga sistemi elektronik i prokurimeve, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Financave nr 33 datë 11.07.2013 “Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, ku për “blerjet e vogla” përcaktohet : “Procesi” Raporti i Vlerësimit Final , me “Referenca ligjore” VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar Kreu VI, pika 2; Udhëzimi nr. 2 datë 28.03.2013 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 1 date 09.03.2011, pikat 5,6; Udhëzimi nr. 7 datë 20.12.2012 “Për zhvillimin e Prokurimeve me Vlerë të Vogël në sistemin elektronik për Autoritetin Kontraktor dhe Operatorët Ekonomik “Aktivitetet e kontrollit”.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Në vijim, të merren masa që në të gjitha procedurat e tenderimeve të përgatiten raportet finale nga ana e anëtarëve të KPVV-ve drejtuar titullarit të institucionit ku të përshkruhen saktë të gjithë hapat e zhvilluar nga shpallja e tenderit deri në shpalljen e fituesit.

**Menjëherë**

**32.** Nga auditimi i sistemit të prokurimeve u konstatuan raste si vijon:

- NjP në asnjë rast nuk ka bërë ri-klasifikim të procedurës, kur ofertuesi i renditur në vendin e parë është tërhequr, duke u mjaftuar vetëm me lajmërimin elektronik në rastet e tërheqjes nga oferta të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës që rezultojnë fitues, në kundërshtim me udhëzimin Nr.5, datë 27.01.2015 “Për zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit Elektronik”/ “Njoftimi i fituesit”;
- Në disa raste AK ka shpallur dy herë radhazi në sistemin e elektronik të prokurimeve me vlerë të vogël dhe kjo procedurë është anuluar. Për këtë NjP nuk ka mbajtur procesverbalin

përkatës sipas formularit 6 të udhëzimit të prokurimeve, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Financave nr 57 datë 12.06.2014 “Gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Të merren masa që në të gjitha procedurat e tenderimeve kur ofertuesi i renditur në vendin e parë tërhiqet nga gara të bëhet ri-klasifikimi në sistemin elektronik nga operatori ekonomik i renditur nga vendi i dytë deri tek i pesti.

Të merren masa që në të mbahen procesverbalet përkatëse nga ana e anëtarëve të KPVV-ve në rastet kur procedurat e shpallura në sistemin elektronik anulohen dy herë radhazi.

**Menjëherë**

**33.** Autoriteti Kontraktor e ka copëzuar vlerën e kontratës së prokurimit për dy tenderët e zhvilluar në vitet 2014-2015 për sigurimin e objekteve QSA Tiranë me roje private, në blerje me vlerë të vogël, negociim pa shpallje dhe kërkesë për propozim, në kundërshtim me ligjin nr 9643, i ndryshuar, në nenin nr 28 “Metodat e përllogaritjes së vlerës në kontratat publike“, ku shprehimisht në pikat 1 dhe dy thuhet 1.) Përcaktimi i vlerës së një kontrate publike bazohet në shumën e plotë të pagueshme pa TVSH, të përllogaritur nga autoriteti kontraktor në çastin e botimit të njoftimit të kontratës të parashikuar në nenin 38 të këtij ligji ose në çastin e fillimit të procedurës së prokurimit, në rastet kur nuk kërkohet një botim i tillë. Përllogaritja merr parasysh shumën e plotë të vlerësuar për t’u paguar, duke përfshirë çdo formë opsioni apo rinovimi të kontratës 2.) Nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara në këtë ligj.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Të merren masa që të realizohen në kohë tenderët për ruajtjen e objektit sapo fondet e përcaktuar nga MAS për QSA të vihen në dispozicion të këtij të fundit.

**Menjëherë**

### **C. MASA DISIPLINORE**

**1.** Nga auditimi është konstatuar se personi përgjegjës për magazinën e institucionit nuk ka ruajtur dokumentacionin e magazinës për vitin 2014 (reflektuar në pikat 18 dhe 19/B “Masa Organizative” të këtij vendimi). Gjithashtu është konstatuar se, **për periudhën janar – tetor 2015** marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara nuk është kryer përmes **komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve** të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin. Hyrja në magazinë e aktiveve të furnizuara është kryer pa respektuar procedurat e specifikuar dhe pa dokumentet mbështetëse të kërkuara nga Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” (reflektuar në pikën 18/B “Masa Organizative” të këtij vendimi).

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, germa c, nenin 58 të ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013 “Për nëpunësin civil”, Institucioni të marrë masa të menjëhershme, për shkeljet e konstatuara lidhur me mbajtjen dhe ruajtjen e dokumentacionit të magazinës, si dhe për dokumentimin e lëvizjeve të aktiveve të ruajtura në to, të japë masën disiplinore nga “vërejtje” deri në “largim nga detyra”, për punonjësin [REDACTED] për parregullsitë cituar me sipër.

**Menjëherë**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në Vendimin nr. 26, datë 31.03.2016, ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.